

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Raport mbi qeverisjen në Komunën e Shtërpcës 2012

Korrik 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	3
2. Problemet në Komunën e Shtërpcës	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Shtërpcës	5
4. Investimet kapitale.....	9
5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011	10
6. Administrata në Komunën e Shtërpcës	10
7. Arsimi dhe Shëndetësia	11
8. Transparenca	12
9. Ecuria e përmbushjes se premtimeve të fushatës zgjedhore - 2009.....	14
10. Burimet:	18

1. Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Shtërpcës bashkëqeveriset me partisë serbe SLS (Partia e Pavarur Liberale Serbe) dhe partisë shqiptare PDK (Partia Demokratike e Kosovës). Kryetari i Komunës z.Bratislav Nikolić vë nga radhët e SLS, parti kjo që në Kuvendin Komunal të Shtërpcës i ka gjithsej nëntë asambleistë, ndërkaq PDK i ka pesë asambleistë. PDK udhëheq edhe me tri drejtori komunale: Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Drejtorinë e Administratës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë. Nga radhët e kësaj partie është zgjedhur edhe nënkryetari i Komunës së Shtërpcës.

Shumicën e vendeve në KK të Shtërpcës i mbajnë partitë shqiptare, përkatësisht nga gjithsej 19 ulëse në Kuvendin Komunal, 9 ulëse i kanë partitë serbe dhe 10 ulëse partitë shqiptare (5 PDK, 2 LDK, 3 PSK-Partia Socialiste e Kosovës).

Zgjedhjet për kryetar komune në Komunën e Shtërpcës janë zhvilluar në dy raunde. Në raundin e parë, partia me më së shumti vota ka qenë PDK, por në balotazh SLS e ka mobilizuar komunitetin që të dalë në votime dhe kësaj në krye të komunës është zgjedhur kandidati i SLS-së Bratislav Nikolić.

Komuna e Shtërpcës gjatë dy viteve të kaluara ka pasur zhvillime në shumë fusha, por shqetësim paraqet shkalla e ulët e të hyrave komunale dhe shpenzimet e larta në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ulja dhe kontrollimi i këtyre shpenzimeve do të duhet adresuar urgjentisht dhe seriozisht nga ana e autoriteteve lokale.

Komuna e Shtërpcës po ashtu llogaritet të këtë nivel tejet të lartë të borxhit publik i cili borxh kalon shifrën e 3 milionë eurove dhe mbetet e paqartë se si autoritetet lokale do të arrijnë t'i shlyejnë faturat e papaguara. Kjo nxjerr në pah shpenzimet e pakontrolluara në këtë komunë, përkatësisht kontraktimin e punëve pa mbulesë financiare. Kjo praktikë duhet të ndërpritet, në të kundërtën rrezikohet se në vitet në vijim e gjithë qarkorja buxhetore për investime kapitale, mallra dhe shërbime si dhe për subvencione të dedikohet për larje borxhesh dhe e gjithë kjo do të vë në pikëpyetje funksionimin stabil të Komunës.

Progresi i përgjithshëm në Komunën e Shtërpcës është sfiduar edhe nga prezenca aktive e strukturave paralele të cilat kontrollohen nga ana e Qeverisë së Serbisë. Këto struktura kanë shtrirë ndikimin e tyre në pothuajse të gjitha fushat e jetës në Komunën e Shtërpcës. Ka pasur mjaft raste kur aktivitetet e këtyre strukturave kanë pasur për

qëllim sabotimin e punës së Komunës së Shtërpcës. Shpeshherë është e pamunduar të bëhet dallimi mes Komunës legjitime të Shtërpcës dhe strukturave paralele, krejt kjo për faktin së këto struktura veprojnë brenda vetë objektit komunal të Shtërpcës. Strukturat paralele shfrytëzojnë gjashtë zyre brenda objektit komunal. Mbledhjet e Kuvendit i mbajnë në ndërtesën e komunës legjitime.

Autoritetet lokale nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret për neutralizimin e këtyre strukturave apo largimin e tyre nga objekti i komunës, përkundrazi veprimet e vetë udhëheqjes së Shtërpcës i kanë inkurajuar këto struktura. Kësisoj në ndërtesën komunale ende është mbishkrimi “Republika e Serbisë – Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë” (“Republika Serbia, Autonomna Pokrajina Kosova i Metohija”). Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Dimitrije Raçiçeviq, lëshon dokumente zyrtare pa logon e Republikës së Kosovës (vetëm me logo komunale), ndërsa Drejtoria e Kadastrës fletë posedimet e tokave i lëshon ende me logo të UNMIK-ut, gjë që është në kundërshtim me normat ligjore në vend dhe Statutin e Komunës. Nëpër dyer të zyrave komunale është vetëm emblema e komunës, ndërsa ajo e Republikës së Kosovës mungon. Por, vulat e Komunës së Shtërpcës kanë emblemën e Republikës së Kosovës dhe janë të shkruara në të dy gjuhët, serbisht dhe shqip.

Instituti GAP ka evidentuar dhe vlerësuar zhvillimet e përgjithshme në këtë komunë. GAP ka evidentuar dhe numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë duke bërë një lidhshmëri pasqyrimesh argumentuese nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parëse publike, shkalla e transparencës, prokurimi publik, funksionimi i administratës dhe ekzekutivit. Gjithashtu janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga kryetarët e këtyre komunave dhe shkalla apo ecuria e realizimit të tyre.

2. Problemet në Komunën e Shtërpçës

Komuna e Shtërpçës ka gjithsejtë 248 km/2 katror dhe me numër të popullsisë afro 14.000 mijë banorë. Pjesën më të madhe e përbën minoriteti serb me gjithsejtë 68%, përdërisa 32% janë shqiptarë. Problemet me të cilat përballen qytetarët në këtë komunë janë specifike dhe kjo është edhe për shkak të rrethanave politike.

Njëra ndër problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët në këtë pjesë të Kosovës është mungesa totale e transmetueseve kombëtar të televizioneve nga Prishtina (RTK, KTV, RTV 21) dhe rrjedhimisht nga kjo, afro 40% e popullatës jo serbe obligohet që të gjitha informatat mediale t'i pranojë vetëm nga kanalet televizive serbe. Kërkesa që Shtërpca të mbulohet me valët televizive nacionale nga Prishtina është edhe e komunitetit serb. Kjo çështje zyrtarisht nuk është ngritur asnjëherë nga ana e autoriteteve komunale të Shtërpçës.

Problem tjetër i cili potencohet nga qytetarët dhe njohësit e rrethanave në Komunën e Shtërpçës është dëmtimi i pyjeve në të gjitha fshatrat duke përfshirë edhe zonën e mbrojtur të Brezovicës. Trendi i dëmtimit të pyjeve nuk ka rënë asnjëherë gjatë gjashtë viteve të fundit. Përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve janë autoritetet komunale. Kompetencat për menaxhimin e pyjeve nga fillimi i 2010 u janë bartur komunave. Shqetësuese mbetet edhe fakti që në zonën e Brezovicës, e cila është një ndër qendrat më të mëdha të skijimit në Ballkan, ka gjithnjë e me shumë ndërtime objektesh pa leje të cilat po ndikojnë në degradimin e asaj zone dhe humbjen e imazhit të mirë.

Ekzistimi dhe shtrirja e strukturave paralele në Komunën e Shtërpçës mbetet problem në vete. Komuna e Shtërpçës nuk menaxhon me mbeturinat në qytet. Këtë veprimtari e kryejnë strukturat paralele, përmes kompanisë së quajtur "Novo Javno Produzece" (Ndërmarrja e Re Publike). Mirëmbajtja e ambienteve është larg standardeve elementare, gjë kjo e cila e bënë qytetin t'i ekspozohet papastërtisë dhe krijimit të stoqeve të shumta të mbeturinave.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Shtërpçës

Komuna e Shtërpçës ka pasur ecuri pozitive për sa i takon të hyrave të përgjithshme komunale. Por, mënyra e shpenzimit të parasë publike është shqetësuese dhe në këtë drejtim autoritetet komunale në Shtërpçë duhet të ndërmarrin masa serioze në përmirësimin e performances së shpenzimit të mjeteve publike.

Shuma e të hyrave për vitin 2011 në total ka qenë 237.800 euro, nga to 38.000 nga tatimi në pronë, 157.000 euro nga ngarkesat administrative, 30.000 nga dënimet e shqiptuara

nga policia, 11.000 nga pylltaria dhe 800 euro nga participimi në shëndetësi. Krahasimi i të hyrave komunale nga viti në vit, rezulton me rritje progresive në vitin e fundit, përkatësisht atë 2011.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale 2008-2011

Viti	Shuma(Euro)
2008	28.077.51
2009	74.474.78
2010	114.263.65
2011	237.800

Gjithsej buxheti për Komunën e Shtërpcës gjatë vitit 2011 ka qenë 4.405.316 euro. Në tabelën nr.2 është prezantuar buxheti komunal sipas kategorive të shpenzimeve.

Tabela nr.2: Buxheti për Komunën e Shtërpcës për vitin 2011

Përshkrimi	Shuma (Euro)
Investime kapitale	2.134.033
Subvencione	10.033
Mallëra dhe shërbime	454.271
Shpenzime komunale	55.992
Paga dhe mëditje	1.750.987
Gjithsejt	4.405.316

Në vitin 2010, Komuna e Shtërpcës ka pasur buxhet në shumën prej 3.743.570.77 euro. Buxheti i vitit 2010 është përcjellë me parregullsi të mëdha, ku Auditori i ka cilësuar si parregullsi me rrezikshmëri të lartë. Auditori ka evidentuar një varg parregullsish, të cilësuar "me rrezikshmëri të lartë", edhe në zyrën e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me dhënien e tenderëve nga Zyra e Prokurimit dhe sipas raportit të Auditorit, në shumicën e rasteve për investimet kapitale të udhëhequra nga Komuna, data e nënshkrimit të kontratës me furnitorin është më e hershme se data në të cilën janë zotuar mjetet në sistemin 'Free Balance'. "Kjo do të thotë se komuna ka publikuar tenderët dhe ka përzgjedhur operatorët fitues pa bërë paraprakisht zotimin e mjeteve në sistemin buxhetor. Aty përmenden disa projekte si 'ndërtimi i tri objekteve në Shtërpcë', për të cilat zotimi i mjeteve ishte bërë më 18 Gusht 2010, ndërsa kontrata me kompaninë ishte nënshkruar më datën 20 Gusht 2010. Pastaj projekti për ndërtimin e qendrës shëndetësore në Shtërpcë, me ç'rast zotimi i mjeteve ishte bërë më 18 Gusht 2010, ndërsa kontrata me kompaninë ishte nënshkruar më datën 24 Shtator 2010, si dhe shumë tenderë tjerë, që nuk kanë pasur zotim paraprak të mjeteve në sistemin 'Free

Balance'. Për të gjitha këto, Auditori ka raportuar se bien ndesh me nenin 9.2 të ligjit nr. 03/L-241 të Prokurimit Publik në Kosovë.¹

Parregullsi të "rrezikshmërisë së lartë" nga Auditori janë konsideruar edhe rastet kur Komuna ka nënshkruar kontrata më të larta se shumat që ka pasur në dispozicion. "Në projektin "Ndërtimi i tri objekteve në Shtërpcë", shuma sipas buxhetit të aprovuar ishte 500 mijë euro, ndërsa shuma e kontratës ishte 1.862.955 euro, që do të thotë se komuna ka nënshkruar një kontratë, e cila është për 1.362.955 euro më e lartë se buxheti i aprovuar (mjetet në dispozicion). Edhe në projektin "Ndërtimi i qendrës shëndetësore në Shtërpcë" shuma sipas buxhetit të aprovuar ishte 500 mijë euro, ndërsa shuma e kontratës ishte 1.647.171 euro, që do të thotë se komuna ka nënshkruar një kontratë e cila është për 1.147.171 euro më e lartë se buxheti i aprovuar (mjetet në dispozicion). Në projektin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Manaj - Firajë" shuma sipas buxhetit të aprovuar ishte 38.719 euro, ndërsa shuma e kontratës ishte 212.387 euro, që do të thotë se komuna ka nënshkruar një kontratë e cila është për 173.668 euro më e lartë se buxheti i aprovuar (mjetet në dispozicion).

Përveç kësaj, performanca buxhetore e Komunës së Shtërpcës konsiston edhe në shpenzime të parave për linjën e mallrave dhe shërbimeve dhe siç u vu re me lartë në këtë kategori kjo komunë gjatë vitit 2011 ka pasur në dispozicion afro gjysmë milioni euro.

Tabela nr.3: Shpenzimet gjatë 2011 nga Komuna e Shtërpcës në linjën për mallra dhe shërbime

Linjat e shpenzimeve	Shuma (Euro)
Derivate për automjete	52.461,90
Dreka dhe darka zyrtare	18.414
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	15.485,84
Mbushje për telefona	9.559,82
Kompjuter	6.830
Material shpenzues për zyre	29.644,58
Dru dhe thëngjill	28.679,25
Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare	7.287
Regjistrimi i automjeteve	3.529
Mirëmbajtja e objekteve	9.100
Pastrimi i rrugëve gjatë dimrit	46.217,60
Pagimi i qirasë	9.230
Reklamat dhe konkurset	3.136
Dhënia e parave personave individual	4.920
Shpenzime të energjisë elektrike	50.163,77

¹ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Shtërpcës 2010. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/AuditOpinion_Shterpcce_2010_Alb_50592.pdf

Pjesa më e madhe e shpenzimeve në linjën për mallëra dhe shërbime sipas raporteve financiare të Komunës së Shtërpcës bëhet nga Zyra e Kryetarit. Kjo zyre vetëm në vitin 2011 ka shpenzuar në linjën për shërbime afro 100.000 euro, apo llogaritur ndryshe afro 50% e shumës totale të hyrave komunale.

Tabela nr.4: Shpenzimet gjatë 2011 nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtërpcës në linjën për mallëra dhe shërbime

Linjat e shpenzimeve	Shuma (Euro)
Dreka dhe darka zyrtare	8.793.10
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	8.206.34
Mbushje për telefona	2.389.82
Kompjuter	3.171.06
Material shpenzues për zyre/ furnizim i zyrës	11.478.85
Blerje telefonash	1.025
Ushqim dhe pije	1.927.15
Shërbime tjera (nuk specifikohet se çfarë shërbimesh)	37.167.00
Reklamat dhe konkurset	2.031.28

Komuna e Shtërpcës në vitin 2010 ka hyrë në borxh, përkatësisht ka lidhur kontrata me operatorët privat për punë dhe shërbime pa pasur mjete financiare në dispozicion dhe kjo ka rezultuar që në vitin 2010 të hyjë në borxh në vlerë prej 821.425 euro. Kjo shumë e borxhit akoma është e papaguar dhe Komuna e Shtërpcës në vend që të rishikonte modalitetet dhe format e fshirjes së këtij borxhi gjatë 2011, ka hyrë gjatë këtij viti (2011) trefish me shumë në borxh, duke krijuar kështu shumën të lartë të borxhit, përkatësisht faturave të shumta të papaguara.

Tabela nr.5: Shuma totale të faturave të papaguara nga Komuna e Shtërpcës 2010 -2011

Viti	Shuma (euro)
2010	821.425
2011	2.301.925
Gjithsejtë	3.123.350

Borxhi prej mbi 3 milionë euro është vlerë jashtëzakonisht e lartë për një komunë si Shtërpca. Një komunë me më pak se 400.000 euro të hyra dhe me mbi 3 milionë euro borxh do të duhet të shërbente si indikacion shqetësues. Në asnjë raport financiar apo të punës se kësaj komune nuk ceket se cila është mënyra apo rruga që do ta ndjek ky institucion për t'i paguar borxhet. Pjesa dërmuese e projekteve të mëdha kapitale të realizuara nga Komuna e Shtërpcës gjatë 2011 janë bërë pa pasur para në dispozicion.

Disa nga këto projekte janë ndërtimi i spitalit në Shtërpçë, ndërtesat për banim, rregullimi i ndriçimit publik dhe rregullimi i qendrës së qytetit në Shtërpçë.

Niveli kaq i lartë i borxhit publik të Komunës së Shtërpçës e ekspozon këtë institucion përball dy faktorëve që mund të ndikojnë thellësisht në funksionimin normal të kësaj komune. Në radhë të parë operatorët privat të cilët i kanë kryer punët publike dhe të cilët nuk janë paguar munden që të padisin komunën në gjykatë dhe për veç kthimit të mjeteve të kontraktura, këta operatorë mund të thirren edhe në parimin e demit anësor duke kërkuar kompensim dhe dëmshpërblim shtesë për veç borxhit bazë. Rrjedhimisht nga kjo nënkuptohet që komunës do t'i duhet të paguajë shifër me të madhe të parave se sa borxhi prej 3.123.350 euro si borxh bazë. Po ashtu si faktor i dytë potencialisht i mundur nga Komuna e Shtërpçës është mundësia që ky institucion të heq dorë për dy vite radhazi nga investimet kapitale për t'i fshirë borxhet, por kjo do të ketë pasoja evidente në terren, ngase asetet publike nuk do të mund të mirëmbahen dhe as të investohet në to.

4. Investimet kapitale

Investimet kapitale nga Komuna e Shtërpçës gjatë dy viteve të kaluara (2010-2011) kapin shifrën e mbi 3 milionë eurove. Gjatë vitit 2010, kryesisht investimet kapitale janë shtrirë në përmirësimin, zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve. Përderisa gjatë 2011 mbi 60% e investimeve kapitale janë fokusuar në rregullimin e objekteve të arsimit, shëndetësisë, fushave sportive dhe rekreative e kështu me radhë.

Tabela. nr.6: Investimet kapitale në Komunën e Shtërpçës (2010 -2011)

Projektet e realizuara	Shuma
Ndërtimi i palestrës sportive	1.372.846,68
Asfaltimi i rrugove lokale në Shtërpçë	246.762,16
Rregullimi i rrugës në fshatin Brod lagjja "Agusha"	85.280,28
Ndërtimi i ndërtesës banesore	688.326,98
Rregullimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatin Brod, lagjja "Ruda"	12.686,13
Rregullimi i rrugës në fshatin Sarkoc-Berevc	21.667,64
Rregullimi i parkut publik Rudinë në Brezovicë	26.882,00
Rregullimi i trotuarit për në Brezovicë	223.535,37
Ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Vicë	14.955,00
Ndërtimi i murit dhe rregullimi i urës në Biti	9.950,00
Asfaltimi i rrugës në fshatin Izancë	30.641,40
Asfaltimi i rrugës në fshatin Brod-Cokla	31.834,80

Asfaltimi i rrugës në fshatin Sevcë lagjja Shubari	114.131,50
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Firaj lagjja e Sulajv	15.973,68
Rregulimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Brezovicë	16.465,58
Asfaltimi i rrugës në Gotovush - aksi i 9	22.178,22
Rregullimi i qendrës në Shtërpçë	52.668,14
Ndërtimi i tri (3) ndërtesave në Shtërpçë	1.516.281,25
Ndërtimi i spitalit në Shtërpçë	1.382.171,18

Cilësia e punëve publike të kryera në Komunën e Shtërpçës përgjithësisht vlerësohet e mirë dhe nuk janë hasur raste kur për një periudhë të shkurter investimet e bëra (rrugët, trotuarët, objektet) kanë nisur të dëmtohen. I vetmi lokalitet (fshatë) në Komunën e Shtërpçës ku nuk ka pasur investime të dukshme është Koshtanjeva dhe kjo besohet të këtë ardhur edhe për faktin se në atë lokalitet banojnë numër i vogël i qytetarëve.

5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Për dy vite (2010-2011), Komuna e Shtërpçës ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 112 kontrata në vlerë të përgjithshme mbi 7 milionë euro. Janë disa raste kur procedurat e prokurimit janë kryer nga ana e Komunës së Shtërpçës, ndërsa paratë (mjetet) kanë qenë të dedikuara për projekte të caktuara nga ana e institucioneve qendrore të Kosovës apo nga donatorët ndërkombëtar, kjo veçmas ka qenë karakteristike e vitit 2010.

Tabela nr.7: Kontratat e Prokurimit në Komunën Shtërpçës
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	54	5.117.295.26
2011	58	2.356.635.60
Totali	112	7.473.930.86

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

6. Administrata në Komunën e Shtërpçës

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Shtërpçës është 344 persona duke përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit fillor, atij të mesëm dhe në sferën e shëndetësisë. Ndërkaq nga ky numër, 65 të punësuar janë në dikasteret e ndryshme në Komunë.

Tabela. nr.5: Numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratën komunale të Shtërpcës

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	12
Drejtoria e Administratës	27
Drejtoria e Financave	11
Drejtoria e Gjeodezisë	5
Drejtoria e Urbanizimit	7
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	5
Drejtoria e Arsimit	5
Drejtoria e Shëndetësisë	4
Spektori i Arsimit	236
Spektori i Shëndetësisë	24
Zjarrfikës/shërbimet publike	7
Zyra për komunitete	1
Gjithsejtë	344

Administrata e Shtërpcës funksionon me 8 Drejtori. Serbët udhëheqin 5 Drejtori të cilat janë: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Gjeodezi dhe kadastër, Drejtoria për Urbanizëm, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia, dhe Drejtoria për Arsim. Shqiptarët i udhëheqin tri Drejtori: Drejtoria për Financat, Drejtoria për Administratën dhe Drejtoria për Shëndetësinë. Çdo Drejtori e ka nga një shef sektori. Nëse drejtori është shqiptar, shefi i sektorit është serb dhe anasjelltas. 70 % e punëtorëve shqiptarë të administratës së Shtërpcës jetojnë në Ferizaj, ndërsa punojnë në Shtërpcë, përfshirë edhe tre drejtorët dhe Nënkryetarin e Komunës. Po ashtu, edhe këshilltari politik i kryetarit të Shtërpcës është nga Smedereva e Serbisë, por punon në Shtërpcë.

7. Arsimi dhe Shëndetësia

Sistemi arsimor në Komunën e Shtërpcës kontrollon dhe menaxhohet nga ana e strukturave paralele serbe. Mësimi zhvillohet me plan-programe të Serbisë. Shkollat kanë drejtorë që zgjedhen dhe paguhen nga Serbia. Drejtori legjitim Komunal i Arsimit është serb, ndërsa shefi i sektorit është shqiptar, mirëpo nuk kanë arritur të kenë menaxhimin e plotë mbi drejtorët e shkollave. Gjendja e objekteve shkollore në përgjithësi është e mirë. Janë katër shkolla shqipe, tri fillore dhe një e mesme, në kuadër të së cilave punojnë afër 90 punëtorë, përfshirë edhe stafin përcjellës jo mësimdhënës.

Shkolla serbe janë gjithsejtë pesë, një e mesme dhe katër fillore. Numri i serbëve të punësuar në arsim është rreth 146.

Auditori i Përgjithshëm ka vlerësuar se gjatë vitit 2010 ka pasur shkelje në punësimin e mësimdhënësve serbë. Sipas Auditorit, gjatë testimit të kryer në listën e pagave janë identifikuar 146 të punësuar serbë në arsim që nuk kanë kontratë valide të nënshkruar. Për të gjithë ata janë disbursuar paga të rregullta mujore në llogaritë e tyre bankare, por asnjëri prej tyre nuk ka nënshkruar formularin e pranimit të pagës. Auditori specifikon se nuk ka gjetur dokumente mbështetëse në bazë të të cilave mund të sigurohet se ata individë (mësimdhënës) me të vërtetë punojnë. Kjo gjendje është nga viti 2008. Rekomandimi i Auditorit nuk është zbatuar.

Sikurse arsimi, edhe shëndetësia primare nuk është e integruar në sistemin legjitim të Shtërpcës. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) udhëhiqet nga drejtori që është zgjedhur nga strukturat paralele dhe njëkohësisht, stafi mjekësor në këtë qendër paguhet nga Serbia. Ndonëse mjekët serbë s'janë integruar në sistemin kosovar, shërbimet mjekësore ata i kryejnë për të gjithë qytetarët, pa dallime etnike. Shërbimet mjekësore që kryhen në QKMF-në e Shtërpcës janë: Gjinekologjia, Urgjenca, Pediatria, Ortopedia dhe analizat e gjakut. Përpos QKMF-së në Shtërpcë ka edhe disa pika shëndetësore në Drekoc, Sevcë, Vërbeshticë, Brod. Shqiptarët frekuentojnë më së shumti në Brod e Drekoc. Në këto ambulanca kryhen shërbimet e mjekësisë së përgjithshme, e në Drekoc edhe disa nga analizat. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në Shtërpcë është shqiptar. Në Komunë të Shtërpcës ka nisur po ashtu ndërtimi i spitalit të qytetit, por akoma nuk ka ndonjë afat kohor se kur mund të pritet inagurimi i objektit dhe rrjedhimisht nga kjo edhe nisja e punës.

8. Transparenca

Autoritetet e Komunës së Shtërpcës nuk e kanë parë me prioritet asnjëherë çështjen e transparencës komunale. Në organogramin e këtij institucioni askund nuk haset e themeluar Zyra për Informim, apo ndonjë person ose departament që është përgjegjës për ushtrimin e këtij funksioni. Komuna nuk e ka të emeruar një zëdhënës apo zyrtar për informim. Bashkëpunimin mes mediave lokale dhe Komunës së Shtërpcës e kryen këshilltari politik i kryetarit të komunës i cili u jep përgjigje mediave edhe për zhvillimet e ndryshme në Drejtorinë Komunale.

Tabela nr.8: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Shtërpçës
<http://kk.rks-gov.net/shterpce/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	√	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizmi, Kadastru dhe Mjedisi	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	Nuk ka asnjë publikim të prokurorit dhe madje nuk është e parapare as hapësira për vendosjen e këtyre raporteve.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	Janë të publikuara: Plani i Punës i KK për 2012 si dhe mund të gjenden të listuara të gjithë projektet e realizuara gjatë 2010 - 2011 dhe planifikimet për 2012								

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar ne ueb-faqe

9. Ecuria e përmbushjes se premtimeve të fushatës zgjedhore - 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Bratislav Nikolić, elektoratit të tij i premtoi një sërë projektesh për ti implementuar në rast se ai zgjidhet kryetar komune. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 7 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Shtërpçës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, vetëm 1 premtim është përmbushur, 5 te tjera nuk ka pasur nisma konkrete për realizueshmërinë e tyre, ndërsa 1 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por akoma nuk mund të vlerësohen të përmbyllur. (Shih tabelen e mëposhtme)

Premtimet e dhëna	Ecuria e realizimit
<p>Ulja e papunësisë</p>	<p>Nuk është realizuar. Papunësia ka mbetur në nivelin e njëjtë. Sipas të dhënave nga QPS-ja në Shtërpçë, janë mbi 3 mijë punëkërkuar. Rreth 66% e qytetarëve të Shtërpçës jetojnë në varfëri, apo 590 familje me rreth 2165 anëtarë, ndërsa 15.9% të tyre në varfëri të skajshme. Gjatë vitit 2011 në zyrën e Qendrës për Punësim kanë kërkuar punë mbi 3113 qytetarë, thuhet në dokumentin, i cili ka qenë pjesë e analizës së Planit Zhvillimor të Shtërpçës. Shtërpca gjatë vitit 2011 ka punësuar në mënyrë sezonale për tre muaj me radhë e me pagë mujore prej 180 euro neto 105 qytetarë të papunë në dy projekte të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që janë implementuar në këtë komunë. Në projektin e parë, janë punësuar 63 qytetarë të moshave të ndryshme në pastrimin e deponive në tërë Komunën, ndërsa në projektin e dytë janë punësuar 42 qytetarë, kanë të bëjnë me pastrimin e zonës së vikendit dhe Qendrës së Skijimit në Brezovicë.</p>

<p>Privatizimin e INEX-it - qendrës së skijimit, ku do të sigurohen 500 vende të reja pune</p>	<p>Privatizimi i INEX Brezovicës nuk ka ndodhur dhe atje nuk është punësuar asnjë qytetar, përpos atyre që përkujdesen për parkingun me afat të caktuar kohor nga 24 dhjetori deri 31 prill. Ndonëse nuk është privatizuar Brezovica, ka nisur puna në hartimin e një plani për zhvillimin e turizmit. Ky plan njihet ndryshe edhe si “Masterplani për Brezovicën” i cili synon rritjen e zhvillimit ekonomik, marrjen e pronësisë dhe punësimin e një numri të madh qytetarësh. Ai është në fazat fillestare. Planin, i cili aktualisht është vetëm në letër e ka ndihmuar Komisioni Evropian në bashkëpunim edhe me Qeverinë e Kosovës (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) dhe Komunën e Shtërpçës. Realizimi i këtij masterplani mund të zgjasë deri në 10 vite. Duhet të theksohet se ky masterplan është prezantuar dy herë në Shtërpçë, në janar 2011 dhe shkurt 2012, por ende asgjë s’ka nisur të punohet praktikisht. Është folur shumë se do të mbahet edhe konferenca e donatorëve, por ajo deri më tash nuk është mbajtur. (Masterplani wshtw prezantuar dy herw, njw herw nw janar 2011 dhe më 09 shkurt 2012).</p>
<p>Investime në qendrën e skijimit me vëmendje të veçantë në sport dhe kulturë</p>	<p>Në Qendrën e Skijimit në Brezovicë nuk ka pasur asnjë investim nga Komuna. Komuna e Shtërpçës nuk ka qasje fare në Qendrën aktuale të skijimit. Ajo menaxhohet nga persona jo zyrtar dhe asnjë e hyrë e saj nuk shkon në buxhetin e Shtërpçës dhe as të Kosovës, përpos të hyrave për parkingun e automjeteve. Qendra e Skijimit në Brezovicë nuk ia paguan taksat as Administratës Tatimore të Kosovës. Ajo i ka borxh ATK-së rreth 4 milion euro taksa.</p>
<p>Integrimin e të gjitha komuniteteve</p>	<p>Mund të quhet si premtim pjesërisht i realizuar. Bashkëpunimi mes komuniteteve është shumë i mirë dhe shembull i veçantë në Kosovë. Shtërpca e ka të formuar Komitetin për Komunitete, në të cilin marrin pjesë të gjitha komunitetet. Duhet të theksohet se në Shtërpçë po integrohen edhe qindra serbë të ardhur pas luftës në këtë komunë. Për ta janë duke u ndërtuar 4 ndërtesa kolektive me gjithsejtë 80 banesa (apartamente). Por, shëndetësia dhe arsimit në Shtërpçë mbeten ende të pa integruara. Këta sektorë ende punojnë me plan-programe të Serbisë dhe nuk i japin llogari organeve legjitime.</p>

<p>Përkujdesje më të madhe ndaj ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë</p>	<p>Edhe në mbrojtjen e ambientit, Komuna nuk ka pasur sukses të mjaftueshëm. Shtërpsa nuk ka ndërmarrje komunale legjitime. Ajo që është aktualisht e që quhet “Ndërmarrja e Re Komunale” (Nova Javno Komunalno Preduzece), që menaxhohet nga strukturat paralele dhe nuk i jep llogari organeve legjitime. Me datën 8 maj 2012, kjo ndërmarrje në Shtërpçë ka shpërndarë kontejnerë me mbishkrimin “Ocistimo Srbiju”. Shpeshherë nëpër institucione e vendbanime, sidomos ku shqiptarët e përbëjnë shumicën, mbeturinat largohen shumë rrallë. Ka ndodhur që nëpër shkollat shqipe, kontejnerët e mbeturinave të pastrohen vetëm 2 herë në vit, edhe pse pagesa bëhet çdo muaj (shih shpenzimet komunale në raportet financiare). Qytetarët paguajnë çdo muaj nga 3 euro për heqjen e mbeturinave. Kontejnerë ka sa të duash (donacione nga USAID-i), por nëpër disa fshatra dhe lagje të tyre nuk janë shpërndarë, psh: Izhanc, Kashtanjevë, pastaj lagjet Coklar, Emërllahaj, etj. Çështje tjetër shqetësuese për mbrojtjen e ambientit, në të cilën Komuna ka dështuar është prerja e pyjeve përmes tenderëve të APK - së, e njohur ndryshe si prerje legale. Rreth 6 mijë metra kub dru janë prerë vetëm gjatë vitit 2011 në pyjet e Shtërpçës dhe po nga aty edhe në vitet paraprake, të cilat janë planifikuar sipas planit menaxherial të Agjencisë Pyjore të Kosovës. Drutë e prera në pyjet e Shtërpçës furnizojnë tërë Ferizajn me rrethinë, por edhe pjesë tjera të Kosovës. Në këtë prerje të quajtur “legale”, nëpërmjet tenderëve të APK-së, nuk ka pasur kontroll të mirë, sepse janë keqpërdorur tenderët, duke u prerë më shumë dru, apo duke u prerë aty ku janë më afër e jo sipas planifikimeve. Për mbrojtjen e pyjeve, Komuna e Shtërpçës nuk ka marrë kurrfarë mase edhe pse kompetencat tashmë u kanë kaluar komunave.</p>
<p>Rrënimin e objekteve që janë jashtë planit, si dhe legalizimin e atyre që janë në përputhshmëri të planit urbanistik</p>	<p>Mund të quhet premtim i realizuar pjesërisht. Në Shtërpçë janë kryer dy faza të rrënitit të objekteve në pronën komunale, shumica e tyre brenda qytezës së Shtërpçës dhe është krijuar një hapësirë e mirë për lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve, është ndërtuar një shatërvan dhe është ndërtuar parkingu publik. Mirëpo rrënimi dhe legalizimi i objekteve nuk ka ndodhur edhe në Brezovicë. Deri me datën 30 prill 2012, Shtërpca e ka pasur në fuqi vendimin, i cili ndalonte shitblerjet e pronave dhe regjistrimin e tyre në librat e kadastrave. Komuna ende nuk e ka hartuar planin urbanistik. Sipas zyrës së Urbanizmit, ai plan është në fazën e katërt të përpilimit. Duke pasur parasysh se në Shtërpçë s’ka plan urbanistik, atëherë edhe nuk kanë mundur të legalizohen, apo rrënohen ndërtimet</p>

	pa leje.
Informimi publik dhe transporti publik	Ky premtim nuk është realizuar. Sot në 90 për qind të territorit të Shtërpcës nuk ka qasje mediumi publik RTK dhe as televizionet nacionale. Po ashtu nuk shitet as edhe një gazetë në gjuhën shqipe. Në anën tjetër të gjitha mediumet serbe nga Beogradi kanë qasje në Shtërpcë dhe të paktën shiten 3 gazeta ditore të Beogradit. Transporti publik është realizuar pjesërisht. Me kërkesën e Komunës, Ministria e Infrastrukturës ka kontraktuar një autobus të “Endriti Company”, i cili bartë falas udhëtarët Ferizaj-Brezovicë dhe anasjelltas tri herë në javë (të martën, mërkurën dhe të enjten) nga tri herë në ditë, mirëpo që nuk i plotëson sa duhet nevojat e qytetarëve. Një pjesë e madhe e zyrtarëve të administratës komunale të Shtërpcës jetojnë në Ferizaj e punojnë në Shtërpcë dhe udhëtojnë falas me këtë autobus.

10. Burimet:

1. Raporti i Financave i Komunës së Shtërpcës 2010 - <http://kk.rks.gov.net/shterpce/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
2. Raporti i Punës i Kryetarit të Komunës së Shtërpcës 2010 - <http://kk.rks.gov.net/shterpce/>
3. Buxheti i Komunës së Shtërpcës 2010 - <http://kk.rks.gov.net/shterpce/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
4. Raporti i Financave i Komunës së Shtërpcës 2011 - <http://kk.rks.gov.net/shterpce/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
5. Buxheti i Komunës së Shtërpcës 2011 - <http://kk.rks.gov.net/shterpce/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
6. Intervistë me Avni Limani – Korrespondent i gazetës “Koha Ditore” në Shtërpcë, maj 2012.
7. Raporti vjetor 2010 – 2011 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - <http://www.mapl-ks.org/raporti> i komunave
8. Raportet vjetore 2010 -2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik http://krpp.rksgov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=64
9. Raporti i OSBE-së për Komunën e Shtërpcës- <http://www.osce.org/sq/kosovo/75451>
10. Njoftimet tabelore për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Shtërpcës http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
11. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare të Komunës së Novobërdës 2010. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/AuditOpinion_Shterpce_2010_Alb_50592.pdf
12. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2013.
13. Raporti i buxhetit i Ministrisë së Financave për vitin 2011.